

Qeverisja gjyqësore: A ekziston një model që vlen për të gjithë?

Autori: Beba Zhagar
Instituti për politikë evropiane - Shkup

Shkup, korrik, 2024

Ky dokument mbi politikën fokusohet në qeverisjen gjyqësore, e cila ka një rol qendror në funksionimin e demokracisë. Ai paraqet, gjithashtu, modelet e ndryshme të qeverisjes gjyqësore të përfaqësuara në vendet anëtare të BE-së, sfidat me të cilat përballen aktualisht dhe modelin e përfaqësuar në Maqedoninë e Veriut.

Hyrje

Pavarësia e gjyqësorit është një nga elementet kryesore të sundimit të drejtës dhe një nga vlerat themelore bazë mbi të cilat bazohet Bashkimi Evropian (BE). Duke marrë parasysh ndarjen e pushteteve dhe sistemin e kontrollit, gjyqësori vepron si një korrigjues ndaj degës ekzekutive dhe veprimeve të partive politike që përbëjnë qeverinë. Pra, gjykatat duhet të mbrojnë sundimin e së drejtës, duke kontribuar kështu në një shoqëri demokratike. Përveç kësaj, gjyqtarët kanë detyrimin dhe përgjegjësinë për të garantuar dhe zbatuar të drejtat e qytetarëve. Të drejtat e tyre nuk mund të zbatohen nëse gjykatat nuk veprojnë në mënyrë të pavarur dhe nuk u përmbahen Kushtetutës dhe ligjeve. Modeli i qeverisjes gjyqësore ka për qëllim të sigurojë që këto dy funksione të degës gjyqësore të kryhen në mënyrë korrekte nga gjyqtarë të pavarur.

Në këtë kërkim të një modeli të qeverisjes gjyqësore që do të siguronte masa mbrojtëse të mjaftueshme për një gjyqësor të pavarur, shumica e vendeve evropiane, përfshirë Maqedoninë e Veriut, janë drejtuar për nga vetëqeverisja gjyqësore, duke krijuar një këshill të fortë gjyqësor, gjë që është promovuar nga BE. Edhe pse ky model mund të duket i përshtatshëm për të arritur qëllimin e tij të synuar në letër, ka shumë shembuj të vendeve ku ai nuk ka arritur ta bëjë këtë. Kjo ka rezultuar në ndarjen e gjyqësorit, por jo dhe pavarësinë e tij nga degët e tjera të pushtetit, gjë që ka çuar në mungesën e pronësisë gjyqësore mbi procesin e qeverisjes gjyqësore.¹ Prandaj, vendet evropiane kanë eksploruar modele të tjera të qeverisjes gjyqësore për të arritur pavarësinë e vërtetë gjyqësore dhe për të rritur besimin e qytetarëve në sistemin gjyqësor.

¹ Denis Preshova, "Të ndarë por jo të pavarur: (Mos)përputhja e kulturës gjyqësore me vetëqeverisjen gjyqësore në Maqedoninë e Veriut ("Separate but Not Independent: The (In)Compatibility of the Judicial Culture with Judicial Self-Governance in North Macedonia)" Instituti për Demokraci "Societas Civilis"—Shkup, Prill 2022), https://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2022/05/B5_Separate-but-not-Independent-The-InCompatibility-of-the-Judicial-Culture-with-Judicial-Self-Governance-in-North-Macedonia.pdf, p. 7.



Qeverisja gjyqësore: përkufizimi dhe modelet

Qeverisja gjyqësore mund të përkufizohet si bashkësia e institucioneve, rregullave dhe praktikave në një juridiksion që organizon, lehtëson dhe rregullon funksionin e degës gjyqësore për zbatimin e ligjit për raste konkrete.² Kjo përfshin mbikëqyrjen e cilësisë së sistemit gjyqësor, caktimin e rasteve për gjyqtarët, emërimin, ngritjen në detyrë dhe shkarkimin e gjyqtarëve, vendosjen e sanksioneve disiplinore ndaj gjyqtarëve, si dhe shpërndarjen e burimeve dhe buxhetit gjyqësor, ndër të tjera.

Ekzistojnë disa modele të ndryshme të qeverisjes gjyqësore që janë identifikuar në BE. Tri modelet kryesore janë si më poshtë: modeli i këshillit gjyqësor, modeli i shërbimit të gjykatave dhe modeli i Ministrisë së Drejtësisë.³ Kur shikon hartën e BE-së, aktualisht, modeli më i shpeshtë i qeverisjes gjyqësore është modeli i këshillit gjyqësor (i njohur ndryshe si modeli i Këshillit të Evropës Jugore), i ndjekur nga modeli i shërbimit të gjykatave (i njohur ndryshe si modeli i Këshillit të Evropës Veriore). Në të njëjtën kohë, më pak i përfaqësuar është modeli i Ministrisë së Drejtësisë.⁴ Megjithatë, ka modele të tjera të qeverisjes gjyqësore përtej këtyre, të cilat janë identifikuar në mbarë botën. Ato përfshijnë modelin ku një njësi administrative administron gjyqësorin, si një Drejtori e Gjykatave,⁵ modelin e Gjykatës së Lartë,⁶ si dhe modele më të decentralizuara ku roli i kryetarëve të gjykatave dhe kryegjyqtarëve është kyç në rregullimin dhe mbikëqyrjen e gjykatave.⁷ Megjithatë, klasifikimi i qeverisjes gjyqësore në modele konkrete është i vështirë sepse shumë vende brenda BE-së dhe në mbarë botën shfaqin karakteristika të ndryshme, duke e bërë kështu të pamundur identifikimin e vetëm një prej modeleve të sipërpërmendura në këto vende. Sisteme të tilla mund të klasifikohen si modele sui generis ose hibride.

Analiza e mëposhtme mbulon tri modelet kryesore të qeverisjes gjyqësore të identifikuara në BE, duke dhënë shembuj të shteteve anëtare për secilin model, duke ilustruar sfidat dhe mangësitë me të cilat përballen.

-Modelet e qeverisjes gjyqësore

Modeli më i shpeshtë i qeverisjes gjyqësore në BE përfshin ngritjen dhe funksionimin e një institucioni të pavarur nga degët e tjera të pushtetit— një këshill gjyqësor. Një institucion i tillë ka kompetenca mbi gjyqtarët në lidhje me emërimet dhe ngritjen e tyre në detyrë, por ai gjithashtu mund të vendosë sanksione disiplinore ndaj gjyqtarëve. Përveç kësaj, është gjithashtu përgjegjës për administrimin e gjyqësorit. Këto kompetenca mbulojnë disa aspekte, të tilla si menaxhimi i softuerit kompjuterik të përdorur nga gjyqësori, pranimi i ankesave të qytetarëve lidhur me sistemin e drejtësisë dhe menaxhimi i ngarkesës së punës gjyqësore.⁸

Ta zëmë se këshilli gjyqësor e kryen rolin e tij pa lejuar asnjë ndërhyrje nga institucione të tjera shtetërore apo figura të partive politike. Në këtë rast, ai mund të konsiderohet modeli më tërësor i qeverisjes gjyqësore, ndonëse jo pa të meta. Në përgjithësi, këshillat gjyqësorë rregullohen nga kushtetutat shtetërore, në mënyrë që të ruajnë pavarësinë e tyre dhe të parandalojnë ndryshimet e shpeshta të rregullimit të tyre nga degët ekzekutive dhe legislative në rast se kjo gjë është parashikuar me ligj. Megjithatë, një rregullim i tillë sjell edhe një rrezik. Nëse lind një nevojë e vërtetë për të ndryshuar përbërjen apo rolin e një këshilli gjyqësor, do të ishte shumë e vështirë të arrihej konsensusi politik që nevojitet për të ndryshuar dispozitat kushtetuese që e rregullojnë atë.

2 Pablo Castillo-Ortiz, "Politikat e zbatimit të modelit të këshillit gjyqësor" ("The politics of implementation of the judicial council model in Europe"), *European Political Science Review*, 2019, <https://bit.ly/3QAbkDI>, p. 503.

3 Pablo Castillo-Ortiz, "Qeverisja gjyqësore dhe demokracia në Evropë" ("Judicial governance and democracy in Europe"), *SpringerBriefs in Law*, 2023, https://doi.org/10.1007/978-3-031-20190-5_1, p. 2.

4 Hartë e shteteve të BE-së, ku është zbatuar parametri i qeverisjes gjyqësore. Judiciary Hub (Democracy Reporting International gGmbH), shiko në: <https://judiciaryhub.eu/map/>.

5 Yair Sagy, Guy Lurie, and Amnon Reichman, "Historia e administrimit të gjykatave në Izrael" ("A history of the administration of courts in Israel") *Journal of Israeli History*, 2022, <https://www.tandfonline.com/doi/full/10.1080/13531042.2023.2235784>, p. 356.

6 Gloria Orrego Hoyos, "Pushëti gjyqësor dhe gjykatat e larta në Amerikën Latine" ("Judicial power and high courts in Latin America"), Hauser Global Law School Program, New York University School of Law, 2021, https://www.nyulawglobal.org/globalex/Judicial_Power_High_Courts_Latin_America.html.

7 Castillo-Ortiz, "Qeverisja gjyqësore dhe demokracia në Evropë" ("Judicial governance and democracy in Europe"), p. 6.

8 *Ibid*, p. 3.

Një çështje e shpeshtë në lidhje me këshillat gjyqësorë është pavarësia e tyre aktuale nga degët e tjera të pushtetit. Në varësi të asaj se cilat institucione emërojnë anëtarët e këshillit gjyqësor dhe nëse kanë fuqinë për t'i shkarkuar, këshilli mund të ndikohet nga qeveria, parlamenti apo presidenti i vendit. Meqë ka shumë kompetenca të qeverisjes gjyqësore, ai mund të jetë nën presion nga anëtarë me ndikim të partive politike që mbajnë funksionin e tyre për të miratuar disa vendime lidhur me karrierën gjyqësore.

Për më tepër, mund të ketë korporatizëm gjyqësor, që ndodh kur gjyqtarët në këshill marrin vendime kolektivisht, duke penguar anëtarët jogjyqtarë të këshillit të shprehin pikëpamjet e tyre. Ky ndikim i brendshëm dallon nga politizimi, i cili është një formë e jashtme e ndikimit mbi këshillin. Në të dy rastet, funksionimi i përgjithshëm i gjyqësorit është i rrezikuar dhe vlerat demokratike të vendit mund të përkeqësohen, siç shihet në vendet e analizuara më poshtë.

Këshilli gjyqësor italian përfaqëson një nga shembujt e parë të këtij modeli.⁹ Këshilli i Lartë i Magistracës numëron tridhjetë anëtarë, njëzet prej të cilëve zgjidhen nga radhët e tyre, ndërsa dhjetë zgjidhen nga Parlamenti. Anëtarët e këtij organi nuk mund të shkarkohen përveçse nëpërmjet një procesi disiplinor dhe mungon mundësia e rizgjedhjes së menjëhershme. Këshilli i Lartë ngarkohet me kompetenca në lidhje me rekrutimin, promovimin, transferimet dhe disiplinimin e magistratëve, zgjedhjen dhe emërimin e kryetarëve të gjykatave, miratimin e rregullave për krijimin e orareve të punës dhe hartimin e opinioneve mbi legjislacionin. Reforma e vitit 2022¹⁰ e gjyqësorit në Itali trajton shqetësime serioze rreth politizimit të Këshillit të Lartë. Nga njëra anë, anëtarët e Këshillit të zgjedhur nga Parlamenti u zgjedhën bazuar në përkatësitë partiake dhe jo në meritat e tyre, duke i hapur derën rrezikut të politizimit.¹¹ Nga ana tjetër, ka pasur shqetësime për ndikimin e shoqatave profesionale të magistratëve në vendimmarrjen në Këshillin e Lartë. Gjegjesisht, magistratët më parë ishin grupuar bazuar në anëtarësimin e tyre në këto shoqata. Prandaj, ato mund të ndikojnë jozyrtarisht në vendimmarrje nëpërmjet votimit të koordinuar brenda këtyre grupeve dhe tregtimit të votave midis grupeve të ndryshme, duke çuar në fund në korporatizëm gjyqësor.¹² Këto tendenca kanë bërë që të ekzistojë një nivel i ulët i pavarësisë së perceptuar gjyqësore midis shtetasve italianë.¹³ Rregullat e reja të futura në vitin 2022 transformuan përbërjen dhe mënyrën e zgjedhjes së Këshillit të Lartë, që synonte reduktimin e ndikimit të partive politike dhe shoqatave profesionale. Kandidatët për anëtarë të Këshillit nuk kanë më nevojë të mbledhin një minimum prej njëzet e pesë nënshkrimesh nga kolegët e të njëjtit qark gjyqësor. Pra, ata nuk kanë nevojë të mbështeten nga një shoqatë e kolegëve të tyre dhe nuk mund të jenë anëtarë të partive politike gjatë mandatit të tyre. Megjithatë, kjo reformë është relativisht e re dhe ajo është zbatuar gjatë zgjedhjeve të anëtarëve të Këshillit në shtator 2022 për anëtarët magistratë të zgjedhur nga radhët e tyre dhe në janar 2023 për anëtarët jomagjistratë të zgjedhur nga Parlamenti.¹⁴ Kështu, mbetet për t'u parë nëse do të japë rezultate të suksesshme për pavarësinë e këtij organi apo nëse do të nevojiten përpjekje të mëtejshme.

Në Poloni,¹⁵ Këshilli Nacional i Gjyqësorit përbëhet nga njëzet e pesë anëtarë, duke përfshirë pesëmbëdhjetë gjyqtarë, katër deputetë, dy senatorë, një përfaqësues të presidentit të Polonisë, kryetarin e parë të Gjykatës së Lartë, kryetarin e Gjykatës së Lartë Administrative dhe Ministrin e Drejtësisë. Ky organ ka fuqinë të përzgjedhë dhe rekomandojë kandidatët për pozicione gjyqësore dhe ngritje në detyrë, të kryejë vlerësimin profesional të gjyqtarëve, të ricaktojë gjyqtarët në poste të tjera, të miratojë rregulla etike dhe të mbikëqyrë respektimin e tyre, si dhe të komentojë mbi draftet legjislative, përfshirë buxhetin dhe aktet e tjera ligjore. Në vitin 2018, mandatet e anëtarëve të Këshillit u ndërpreu dhe Parlamenti futi një model të ri për emërimin e gjyqtarëve në Këshill.¹⁶ Anëtarët e rinj të Këshillit u emëruan nga koalicioni i mëparshëm qeverisës në parlament dhe perceptohen si përfaqësues dhe mbrojtës të

9 Profili i shtetit: Italia. Judiciary Hub (Democracy Reporting International GmbH), shiko në: <https://judiciaryhub.eu/country/italy/>.

10 Francesco Palermo, "Reforma gjyqësore në mesin e krizës" ("Judicial Reform in the Midst of Crisis"), Legal Tribune Online, 2 gusht, 2022, <https://www.lto.de/recht/justiz/jj/judicial-system-reform-italy-overlong-proceedings-judges-independence/>.

11 Simone Benvenuti and Davide Paris, "Vetëqeverisja gjyqësore në Itali: Meritat, kufizimet dhe realiteti i modelit të eksportit" ("Judicial Self-Government in Italy: Merits, Limits and the Reality of an Export Model"), Cambridge University Press, 6 mars, 2019, <https://www.cambridge.org/core/services/aop-cambridge-core/content/view/6802EA8FD4B-CFF18FA18DC35B3D2361C/S2071832200023191a.pdf/judicial-self-government-in-italy-merits-limits-and-the-reality-of-an-export-model.pdf>, p. 1657.

12 Simone Benvenuti, "Politikat e llogaridhënies gjyqësore në Itali: Zhvendosja e balancit" ("The Politics of Judicial Accountability in Italy: Shifting the Balance"), Cambridge University Press, 4 korrik, 2018, <https://bit.ly/3VY1aht>, p. 383.

13 "2023 Raport për sundimin e ligjit - Kapitulli i shtetit mbi situatën e sundimit të ligjit në Itali" ("2023 Rule of Law Report - Country chapter on the rule of law situation in Italy"), Komisioni Evropian, 2023, https://commission.europa.eu/system/files/2023-07/29_1_52611_coun_chap_italy_en.pdf, p. 3.

14 Ibiid, p. 4.

15 Profili i shtetit: Polonia. Judiciary Hub (Democracy Reporting International GmbH), shiko në: <https://judiciaryhub.eu/country/poland/>.

16 Christian Davies, "Uzurpimi armiqësor: Si ligji dhe drejtësia pushtuan gjykatat e Polonisë" ("Hostile takeover: How law and justice captured Poland's courts"), Freedom House, 2018, <https://freedomhouse.org/report/analytical-brief/2018/hostile-takeover-how-law-and-justice-captured-polands-courts>, p. 5.

interesave politikë të partisë së tyre e jo të pavarësisë dhe integritetit të gjyqësorit.¹⁷ Që nga viti 2018, veprimet e Këshillit kanë çuar në shkelje të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe ligjit të BE-së, duke kontribuar në cenueshmërinë e gjyqtarëve ndaj presioneve të jashtme dhe duke ndikuar në pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre. Si pasojë, gjyqtarët janë angazhuar në aktivitete të ndryshme për t'u mbrojtur nga presioni politik, duke formuar shoqata gjyqësore dhe duke inicuar raste përpara Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) dhe Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJDBE) lidhur me statusin e tyre dhe çështje më të gjera.¹⁸

Pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2023,¹⁹ qeveria e re vendosi të adresojë krizën e sundimit të ligjit dhe të ndryshojë reformën e procesit zgjedhor të anëtarëve të Këshillit.²⁰ Megjithatë, kjo përpjekje mund të pengohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila perceptohet si e politizuar dhe pa pavarësi²¹ dhe nga Presidenti i Polonisë, i cili është armiqësor ndaj reformimit të gjyqësorit dhe anulimit të ndryshimeve që ai ka miratuar.²² Një nga hapat e parë të kësaj reforme ishte nxjerrja e një rezolute jodetyruese nga ana e Kuvendit, e cila e shpalli Këshillin Nacional të Gjyqësorit si organ pa pavarësi.²³ Pas kësaj, përfundoi faza e parë e miratimit të ligjit për rivendosjen e procedurës me të cilën shumica e anëtarëve të Këshillit Nacional të Gjyqësorit zgjidhen në zgjedhje të fshehta dhe të drejtpërdrejta nga radhët e tyre.²⁴ Analiza e modelit të këshillit gjyqësor përmes përvojës së Polonisë tregon se megjithëse këshilli gjyqësor është themeluar si një organ i pavarur në letër, realiteti nuk pasqyron një pavarësi të tillë. Partitë politike mund të ushtrojnë ndikim në këshillin gjyqësor duke emëruar anëtarët e tij, duke ushtruar presion mbi gjyqtarët, duke çuar në gjykimet subjektive dhe duke përkeqësuar përfundimisht sundimin e ligjit.

Një ndikim i tillë politik është gjithashtu i pranishëm në Këshillin e Lartë Gjyqësor të Bullgarisë.²⁵ Më parë ai përbëhej nga dy kolegje: gjyqësor dhe prokurorial. Kolegji Gjyqësor kishte katërbëdhjetë anëtarë: gjashtë të zgjedhur nga gjyqtarë nga radhët e tyre, gjashtë të zgjedhur nga Parlamenti Nacional dhe dy anëtarë ex officio - kryetari i Gjykatës së Lartë të Kasacionit dhe kryetari i Gjykatës së Lartë Administrative. Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit të Këshillit të Evropës (GRECO) ka ngritur shqetësime në lidhje me procesin e emërimit të anëtarëve të Kolegjit Gjyqësor të Këshillit, duke paralajmëruar se numri i konsiderueshëm i anëtarëve të emëruar nga parlamenti nacional²⁶ mund të politizojë vendimmarrjen dhe të minojë pavarësinë e Këshillit. Këta anëtarë priren të veprojnë në përputhje me preferencat qeveritare, duke ngritur pyetjen nëse pavarësia e Këshillit ekziston vetëm në letër ndërsa, në praktikë, ajo është në duart e pushtetit ekzekutiv.²⁷ Pas kësaj vërejtjeje, Komisioni Evropian (KE) rekomandoi që Bullgaria të ndryshojë përbërjen e Këshillit për të përfshirë më shumë gjyqtarë të zgjedhur nga radhët e tyre. Fillimisht, qeveria informoi KE-në se një ndryshim i tillë do të kërkonte një amendament kushtetues, gjë që nuk mund të arrihej lehtë në kontekstin politik të asaj kohe.²⁸ Megjithatë, për të korrigjuar këtë situatë, Kuvendi miratoi ndryshimet në Kushtetutën e Bullgarisë në dhjetor 2023.²⁹ Këto ndryshime parashikojnë ndarjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor në dy

17 Ibid, p.6.

18 Claudia Matthes, "Gjyqtarët si aktivistë: Si mobilizohen gjyqtarët polakë për të mbrojtur sundimin e ligjit" (Judges as activists: How Polish judges mobilise to defend the rule of law), East European Politics, 2022, <https://doi.org/10.1080/21599165.2022.2092843>, p. 473-477.

19 Piotr Maciej Kaczyński and Dariusz Dybka, "Polonia liberale është kthyer: Ndikimi i votës polake të 2023 mbi Evropën" ("Liberal Poland is back: The impact on Europe of the 2023 Polish vote") Royal Institute Elcano (blog), 13 shkurt, 2024, <https://www.realinstitutoelcano.org/en/analyses/liberal-poland-is-back-the-impact-on-europe-of-the-2023-polish-vote/>.

20 "Qeveria polake miraton ndryshimet për të hequr ndikimin politik mbi Këshillin Gjyqësor" ("Polish Government approves changes to remove political influence over Judicial Council,") Notes from Poland, 21 shkurt 2024, <https://notesfrompoland.com/2024/02/21/polish-government-approves-changes-to-remove-political-influence-over-judicial-council/>.

21 Tomasz Tadeusz Konwicz, "Përse Evropa nuk duhet të harrojë asnjëherë Gjykatat kushtetuese të Polonisë: mbi rëndësinë e kujtesës institucionale të Evropës" ("Why Europe must never forget about the Polish Constitutional Court: On the importance of European institutional memory") Verfassungsblog (blog), July 10, 2023, <https://verfassungsblog.de/why-europe-must-never-forget-about-the-polish-constitutional-court/>, p. 19.

22 Rob Schmitz, "Gjyqësori i Polonisë ishte një mjet i qeverisë së saj: Udhëheqësit e rinj po përpiqen ta zhbëjnë këtë" ("Poland's judiciary was a tool of its Government. New leaders are trying to undo that"), National Public Radio (blog), 26 shkurt, 2024, <https://www.npr.org/2024/02/26/1232834640/poland-courts-judicial-reform-donald-tusk>.

23 "Parlamenti polak voton për rezolutën e reformës gjyqësore" ("Polish Parliament votes for court reform resolution") Reuters, 21 dhjetor, 2023, <https://www.reuters.com/world/europe/polish-parliament-votes-court-reform-resolution-2023-12-21/>.

24 "Parlamenti polak miraton projektligjin për të anuluar reformën e mëparshme të qeverisë së Këshillit Gjyqësor" ("Polish Parliament Passes Bill to Reverse Previous Government's Reform of Judicial Council") Notes from Poland (blog), 13 prill, 2024, <https://notesfrompoland.com/2024/04/13/polish-parliament-passes-bill-to-reverse-previous-governments-reform-of-judicial-council/>.

25 Profili i vendit: Bullgaria. Judiciary Hub (Democracy Reporting International gGmbH), shiko në: <https://judiciaryhub.eu/country/bulgaria/>.

26 "Raundi i pestë i vlerësimit: Parandalimi i korrupsionit në mesin e deputetëve, gjyqtarëve dhe prokurorëve" ("Fourth evaluation round: Corruption prevention in respect of members of parliament, judges and prosecutors, Second Compliance Report Bulgaria"), GRECO, January 17, 2020, <https://rm.coe.int/fourth-evaluation-round-corruption-prevention-in-respect-of-members-of/16809981f2>, p. 4.

27 Radosveta Vassileva, "Këshilli Gjyqësor polak kundër Këshillit Gjyqësor Bullgar: A mund të gjesh dallimin?" ("The Polish Judicial Council v the Bulgarian Judicial Council: Can you spot the difference?") Verfassungsblog (blog), 22 shtator, 2018, <https://verfassungsblog.de/the-polish-judicial-council-v-the-bulgarian-judicial-council-can-you-spot-the-difference/>, p. 2.

28 "2023 Raporti për sundimin e ligjit - Kapitulli i shtetit mbi situatën e sundimit të ligjit në Bullgari" ("2023 Rule of Law Report—Country chapter on the rule of law situation in Bulgaria") Komisioni Evropian, 2023, https://commission.europa.eu/system/files/2023-07/10_1_52568_coun_chap_bulgaria_en.pdf, p. 8.

29 Iana Fremer, "Bullgaria: Amendamentet e reja kushtetuese paraqesin reformën në drejtësi dhe heqin kërkesën që zyrtarët e lartë publikë të kenë vetëm nënshtetësinë bullgare" ("Bulgaria: New constitutional amendments introduce judicial reform and abolish requirement for senior public officials to hold only Bulgarian citizenship") Biblioteka e drejtësisë e Kongresit, 21 janar, 2024, <https://bit.ly/4aQltCN>.

entitete të veçanta, Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, të cilat synojnë të ushtrojnë kompetencat e tyre në mënyrë të pavarur. Këshilli i Lartë Gjyqësor ruajti kompetencat e tij në lidhje me emërimet, ngritjet në detyrë, transferimet dhe shkarkimet e gjyqtarëve, si dhe detyrën për certifikimin periodik të gjyqtarëve, vendosjen e dënimeve disiplinore, zgjidhjen e çështjeve organizative në lidhje me veprimtarinë gjyqësore, miratimin e projekt-buxhetit të sistemit gjyqësor dhe mbikqyrjen e zbatimit të buxhetit. Vërejtjet e mësipërme për emërimin e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor adresohen me amandamente kushtetuese, të cilat ndryshojnë përbërjen e tij. Do të ketë pesëmbëdhjetë anëtarë në Këshill, tetë prej të cilëve do të zgjidhen drejtpërdrejt nga gjyqtarët, pesë anëtarë do të zgjidhen nga Parlamenti Nacional dhe dy anëtarët ex officio do të mbeten të njëjtë. Mbetet për t'u parë nëse këto ndryshime do të rrisin vërtet pavarësinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor në mënyrë që ai të jetë në gjendje të ushtrojë kompetencat e tij në interes të qytetarëve dhe të vendit dhe jo t'u nënshtrohet kërkesave të partive politike në pushtet.

Një shembull tjetër interesant i modelit të këshillit gjyqësor është Sllovakia,³⁰ ku ky institucion është kritikuar për korporatizëm gjyqësor për gati dy dekada. Aktualisht, ai përbëhet nga tetëmbëdhjetë anëtarë, me nëntë gjyqtarë të zgjedhur nga radhët e tyre. Anëtarët e mbetur emërohen nga presidenti i republikës, qeveria dhe Këshilli Nacional, duke krijuar një ekuilibër midis gjyqtarëve dhe jogjyqtarëve në Këshill. Si rrjedhojë, ky këshill duhet të rrisë kontrollin publik të gjyqësorit dhe të parandalojë anëtarët gjyqtarë nga mbizotërimi i tyre në Këshill. Detyrat e tij përfshijnë propozimin e kandidatëve që kanë të drejtë të emërohen gjyqtarë të presidentit të republikës, si dhe e kandidatëve për t'u emëruar kryetarë dhe nënkryetarë të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës së Lartë Administrative, marrjen e vendimit për caktimin dhe transferimin e gjyqtarëve, propozimin e gjyqtarëve kandidatë që duhet të përfaqësojnë republikën në organet gjyqësore ndërkombëtare në qeveri, komentimin e projektbuxhetit të gjykatave, nxjerrjen e parimeve të etikës gjyqësore, në bashkëpunim me organet e vetëadministrimit gjyqësor, pjesëmarrjen në menaxhimin dhe administrimin e gjykatave, miratimin e masave për forcimin e besimit të publikut në gjyqësor etj.

Para se të prezantohej Këshilli Gjyqësor, kompetencat që lidheshin me karrierën gjyqësore i mbante ekzekutivi. Kështu, kishte shpresë të madhe se me punën e tij, ky institucion do të lehtësonte gjyqtarët nga ndikimet e jashtme dhe politizimi. Megjithatë, sapo u vlerësua zgjidhja e atij problemi, kjo iniciativë shkoi në një drejtim tjetër nga sa pritej. Kjo kontribuoi në ngritjen e elitave gjyqësore dhe zvogëlimin e llogaridhënies demokratike.³¹ Para ndryshimeve kushtetuese në vitin 2020,³² nuk kishte rregullore që të menaxhojë ekuilibrin midis gjyqtarëve dhe jogjyqtarëve në Këshill. Kjo çoi në një mbizotërim të gjyqtarëve: fillimisht, ata përbënin dy të tretat e të gjithë anëtarëve në mandatin e parë, duke u rritur në 16 anëtarë në mandatin e dytë.³³ Rrjedhimisht, anëtarët gjyqtarë kishin shumicën e votave në Këshill, gjë që çoi në vendime të marra bazuar në interesat e tyre dhe jo në vendime cilësore dhe të paanshme të marra në interes të të gjithë gjyqësorit dhe, në fund të fundit, të qytetarëve të Sllovakisë. Ndërsa kjo çështje është trajtuar me amandamente kushtetuese, vazhdojnë të ekzistojnë disa shqetësime që janë theksuar nga KE. Përkatesisht, parakushtet për shkarkimin e anëtarëve jogjyqtarë të Këshillit ende nuk rregullohen me ligj, gjë që mundëson një mjedis ku ata mund të largohen nga detyra para kohe dhe në mënyrë arbitrare. KE ka bërë një rekomandim, i cili është përsëritur në vitin 2023, që anëtarët e Këshillit Gjyqësor duhet t'u nënshtrohen garancive të mjaftueshme të pavarësisë në lidhje me shkarkimin e tyre, duke marrë parasysh standardet evropiane për pavarësinë e këshillave gjyqësorë.³⁴ Megjithatë, Sllovakia ende nuk i ka prezantuar këto ndryshime ligjore, duke argumentuar se mungesa e rregulloreve të tilla nuk është keqtrajtuar në praktikë. Për më tepër, arritja e shumicës kushtetuese të nevojshme për miratimin e këtyre ndryshimeve duket e pamundur në kontekstin aktual politik.³⁵

30 Profili i shtetit: Sllovakia. Judiciary Hub (Democracy Reporting International GmbH), shiko në: <https://judiciaryhub.eu/country/slovakia/>.

31 Samuel Spáč, Katarína Šipulová, and Marína Urbániková, "Kapja e gjyqësorit nga brenda: Historia e vetëqeverisjes gjyqësore në Sllovaki" ("Capturing the Judiciary from Inside: The Story of Judicial Self-Governance in Slovakia") Cambridge University Press, 6 mars, 2019), <https://bit.ly/3zluall>, p. 1741.

32 Peter Čuroš, "Panoptikoni i Gjyqësorit Slovak - Vazhdimësia e qendrave të pushtetit dhe varësia mendore" ("Panopticon of the Slovak Judiciary – Continuity of Power Centers and Mental Dependence"), Cambridge University Press, 27 tetor 2021), <https://bit.ly/3zk47dX>, p. 1278-1279.

33 Simona Farkašová, "Reforma Kushtetuese e Këshillit Gjyqësor në Republikën Slovake nga konteksti krahasues evropian" ("The Constitutional Reform of the Judicial Council in the Slovak Republic from the European Comparative Context") Bukuresht Akademia e Studimeve Ekonomike, qershor 2022, <https://tribunajuridica.eu/arkiva/An12v2/1%20Simona%20Farkasova.pdf>, p. 169.

34 "Raport për sundimin e ligjit 2023 - Kapitulli i shtetit mbi situatën e sundimit të ligjit në Sllovaki" ("2023 Rule of Law Report—Country chapter on the rule of law situation in Slovakia"), Komisioni Evropian, 2023, https://commission.europa.eu/document/download/bbc910bb-df4a-49df-a86e-3b6c7b7ebb83_en?filename=56_1_52633_coun_chap_slovakia_en.pdf, p. 5.

35 "RAPORTI EVROPIAN PËR SUNDIMIN E LIGJIT 2023: Kontributi i Republikës Slovake, (EUROPEAN RULE OF LAW REPORT 2023: Input of the Slovak Republic)", Komisioni Evropian, korrik 2023, https://commission.europa.eu/system/files/2023-07/103_1_52820_input_mem_slovakia_en.pdf, p. 2.

-Modeli i shërbimit të gjykatave

Ndërsa modeli i shërbimit të gjykatave përfshin gjithashtu praninë e një institucioni të veçantë që menaxhon gjyqësorin si në modelin e këshillit gjyqësor, dallimi kryesor midis këtyre dy modeleve është se kompetencat e shërbimeve të gjykatave janë kryesisht të lidhura me administrimin dhe menaxhimin e gjykatave. Nga ana tjetër, kompetencat e saj mbi karrierën gjyqësore janë shumë më të kufizuara. Modeli i shërbimit të gjykatave parashikon një organizatë ndërmjetëse të pavarur, funksionet e së cilës janë të përqendruara në administrimin (mbikëqyrja e zyrave të regjistrimit gjyqësor, ngarkesat e çështjeve, normat e fluksit, promovimi i uniformitetit ligjor, kujdesi cilësor, etj.), menaxhimin e gjykatave (strehimi, automatizimi, rekrutimi, trajnimi, etj.), dhe buxhetimin e gjykatave.³⁶

Prandaj, shërbimet gjyqësore kanë një rol të kufizuar në emërimin dhe ngritjen në detyrë të gjyqtarëve, si dhe në vendosjen e sanksioneve disiplinore ndaj tyre. Në vendet që kanë miratuar këtë model të qeverisjes gjyqësore, role të tilla u jepen organeve të pavarura, siç janë komisionet, që funksionojnë në mënyrë të pavarur nga shërbimi gjyqësor. Prandaj, është diskutabile nëse ky model është një model i veçantë në vetvete apo një hibrid që përfshin elemente të modelit të këshillit gjyqësor të kombinuar me karakteristika të tjera. Gjithashtu, duke qenë se modeli i shërbimit gjyqësor nuk ka të gjitha kompetencat e këshillit gjyqësor, mund të vihet në dyshim efektiviteti i tij. Fuqia vendimmarrëse sa i përket karrierës gjyqësore është ndoshta aspekti më i rëndësishëm i qeverisjes gjyqësore që ndikon në pavarësinë e përgjithshme të gjyqësorit; kështu, është i nevojshëm një rregullim adekuat i kësaj çështjeje.

Një nga shtetet anëtare të BE-së që ka miratuar këtë model është Belgjika.³⁷ Atje, Këshilli i Lartë i Drejtësisë përfaqëson shërbimin gjyqësor dhe përbëhet nga dyzet e katër anëtarë, përfshirë gjyqtarë, avokatë, profesorë universitarë dhe përfaqësues të shoqërisë civile, të cilët kanë mandate katërvjeçare. Ky institucion ka për detyrë organizimin e provimeve, përgatitjen e udhëzimeve të përgjithshme për trajnime gjyqësore dhe trajnime të vazhdueshme, mbikëqyrjen e jashtme për funksionimin e rendit gjyqësor dhe marrjen e nismave dhe dhënien e këshillave për përmirësimin e funksionimit të sistemit të drejtësisë. Përveç kësaj, ekzistojnë dy gjykata disiplinore dhe dy gjykata të apelit, të cilat janë kompetente për gjykimin e gjyqtarëve dhe anëtarëve të tjerë të gjyqësorit dhe kanë për detyrë të prodhojnë raporte për çështjet disiplinore. Sfidat me të cilën përballlet ky model në Belgjikë lidhet me ndarjen gjuhësore në vend dhe sistemin politik, gjë që reflektohet edhe në Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe ka shkaktuar bllokime në emërimet gjyqësore.³⁸ Nëse nuk zgjidhet sa më shpejt, kjo çështje mund të ndikojë në funksionimin e gjykatave dhe cilësinë e drejtësisë, si dhe të ulë besimin e publikut në sistemin gjyqësor.

Një tjetër shtet anëtar i BE-së me të njëjtin model të qeverisjes gjyqësore është Holanda.³⁹ Megjithatë, këtu ndarja e përgjegjësisë në gjyqësor është shumë më e komplikuar sesa në Belgjikë. Në Holandë, Këshilli për Gjyqësorin përbëhet nga tre deri në pesë anëtarë dhe ka për detyrë përgatitjen e buxheteve për gjykatat, shpërndarjen e fondeve midis gjykatave, mbikëqyrjen e zbatimit të buxheteve, mbështetjen dhe mbikëqyrjen e operacioneve në gjykata, ndihmën për të siguruar cilësinë e drejtësisë etj. Çdo gjykatë ka bordin e vet drejtues të gjykatave të përbërë nga tre anëtarë, duke përfshirë një kryetar gjykate, i cili është përgjegjës për miratimin e rregulloreve të brendshme për metodat e punës, caktimin e rasteve, menaxhimin e rasteve, menaxhimin e përditshëm të gjykatave, marrjen e vendimeve për ngritje në detyrë në gjykatat e qarkut dhe të apelit etj. Komisioni nacional i përzgjedhjes përbëhet nga gjashtë gjyqtarë dhe gjashtë anëtarë jogjyqtarë dhe fillimisht përzgjedh gjyqtarët kandidatë. Në të njëjtën kohë, Ministri i Drejtësisë dhe Sigurisë nënshkruan vendimin e emërimit, i cili nënshkruhet edhe nga Mbreti. Megjithatë, gjyqtarët nuk zgjedhin anëtarët gjyqtarë të organeve drejtuese, siç është Këshilli për Gjyqësorin, gjë që lë hapësirë për ndikim nga dega ekzekutive. Aktualisht po shqyrtohet mundësia e ndryshimit të procedurës së përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit për kufizimin e ndikimit të ministrit të drejtësisë dhe sigurisë.⁴⁰

36 Michal Bobek dhe David Kosař, "Zgjidhje globale, dëme lokale: Një studim kritik në këshillat gjyqësorë në Evropën Qendrore dhe Lindore" (Global solutions, local damages: A critical study in judicial councils in Central and Eastern Europe), German Law Journal, 2014, <https://bit.ly/49LBKIM>, f. 1266.

37 Profili i vendit: Belgjika. Judiciary Hub (Democracy Reporting International GmbH), shiko në: <https://judiciaryhub.eu/country/italy/>.

38 Tensionet mes holandishtfolësve dhe frëngjishtfolësve paralizojnë Këshillin e Lartë të Drejtësisë ("Tensions between Dutch and French speakers paralyze the High Council of Justice") La Libre, 11 tetor, 2023, <https://www.lalibre.be/belgique/judiciaire/2023/10/11/les-tensions-entre-neerlandophones-et-francophones-paralysent-le-conseil-superieur-de-la-justice-2FINEO2IEFGEP4WBXPDTGZDLY/>.

39 Profili i vendit: Holanda. Judiciary Hub (Democracy Reporting International GmbH), shiko në: <https://judiciaryhub.eu/country/netherlands/>.

40 "Raporti për sundimin e ligjit 2023 - Kapitulli i shtetit mbi situatën e sundimit të ligjit në Holandë" ("2023 Rule of Law Report - Country chapter on the rule of law situation in the Netherlands"), Komisioni Evropian, 2023, https://commission.europa.eu/system/files/2023-07/44_1_52625_coun_chap_netherlands_en.pdf, p. 5.

-Modeli i Ministrisë së Drejtësisë

Modeli i tretë i qeverisjes gjyqësore, i cili është më pak i përfaqësuar brenda shteteve anëtare të BE-së, është modeli i Ministrisë së Drejtësisë. Ai është gjithashtu shumë ndryshe nga dy modelet e lartpërmendura, ku dallimi më i dukshëm është se institucioni përgjegjës për qeverisjen e sistemit gjyqësor është Ministria e Drejtësisë, si pjesë e degës ekzekutive dhe jo një institucion i pavarur. Në këto sisteme, Ministria e Drejtësisë luan një rol kyç në emërimin dhe ngritjen në detyrë të gjyqtarëve dhe në administrimin dhe menaxhimin e gjykatave.⁴¹ Megjithatë, në vendet ku është adoptuar ky model, ka pasur një ndikim në rritje të gjyqtarëve në qeverisjen gjyqësore për të balancuar ndikimin mbizotërues të degës ekzekutive.⁴²

Ndërsa ky është modeli më jetëgjatë i qeverisjes gjyqësore, mangësia e tij kryesore është e dukshme. Me Ministrinë e Drejtësisë si një aktor kryesor, ekziston rreziku që partia politike në pushtet mund të ushtrojë kontroll mbi gjyqësorin, përfshirë vendimet për emërimet dhe shkarkimet e gjyqtarëve. Kjo mund të dëmtojë pavarësinë e gjyqësorit, të dobësojë sistemin e kontrollit dhe përfundimisht të kontribuojë në erozionin e sundimit të ligjit në vend.

Një nga shtetet anëtare të BE-së që ka miratuar këtë model të qeverisjes gjyqësore është Gjermania.⁴³ Ajo ka kundërshtuar vazhdimisht modelin e këshillit gjyqësor sepse krijimi i një këshilli të tillë, ku gjyqtarët e zgjedhur nga radhët e tyre kanë shumicën për të vendosur për karrierën gjyqësore, do të ishte diçka antikushtetuese. Kjo për shkak se mandati i tyre administrativ nuk do të rrjedhë nga populli gjerman.⁴⁴ Brenda këtij modeli, Ministria federale e Drejtësisë është përgjegjëse për administrimin e gjykatave federale, ndërsa ministrinë kompetente mbikëqyrin gjykatat në nivel shtetëror. Gjithashtu, Ministria e Drejtësisë është përgjegjëse edhe për emërimet gjyqësore, përfshirë emërimet e kryetarëve të gjykatave. Për më tepër, ka këshilla emërimi të krijuar në nivel shteti, të cilët marrin pjesë në procesin e emërimit duke përgatitur një mendim me shkrim që përmban aftësinë personale dhe profesionale të gjyqtarit. Në mënyrë të ngjashme, në nivelin federal, një komitet emërimi përbëhet nga ministri federal kompetent, ministrat e shtetit dhe anëtarët e zgjedhur nga Bundestagu. Ky komitet emëron gjyqtarë të gjykatave federale, por përbërja e tij ngre shqetësime në lidhje me politizimin e mundshëm të procesit, i cili mund të dëmtojë pavarësinë gjyqësore.

Ndërsa ndikimi i degës ekzekutive është në një masë më të madhe në Gjermani, ka ende mundësi për pjesëmarrje gjyqësore në qeverisjen gjyqësore. Ka këshilla gjyqtarësh, të cilët marrin pjesë në të gjitha çështjet që lidhen me jetën profesionale të gjyqtarëve, përveç procesit të emërimit. Megjithatë, kompetencat e këshillave të tillë varen nga shteti, sepse ata nuk rregullohen në nivel federal. Megjithatë, praktika të tjera që janë krijuar në Gjermani për të parandaluar minimin e pavarësisë gjyqësore dhe përkeqësimin e sundimit të ligjit,⁴⁵ shoqatat gjyqësore në vend kanë vazhduar të bëjnë thirrje për përfshirje më të madhe gjyqësore përmes krijimit të një këshilli gjyqësor. Deri më tani, nuk ka asnjë lëvizje në atë drejtim që synon zvogëlimin ose marrjen fund të ndikimit të qeverisë në gjyqësor dhe emërimit të gjyqtarëve në pozita të larta për shkak të lidhjes së tyre me partitë e mëdha politike.⁴⁶

Një shtet tjetër anëtar i BE-së që ka miratuar modelin e Ministrisë së Drejtësisë është Republika Çeke.⁴⁷ Në këtë vend, është futur një reformë e madhe e procesit të përzgjedhjes në gjyqësor me ndryshimet në Aktin për Gjykatat dhe Gjyqtarët, i cili hyri në fuqi më 1 janar 2022.⁴⁸ Këto ndryshime paraqitën një sistem të ri të përzgjedhjes së gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave, me qëllim korrigjimin e metodës së mëparshme të përzgjedhjes, ku kryetarët e gjykatave

41 Bobek and Kosař, "Zgjidhje globale, dëme lokale: një studim kritik në këshillat gjyqësorë në Evropën Qendrore dhe Lindore" ("Global Solutions, Local Damages: A Critical Study in Judicial Councils in Central and Eastern Europe"), p. 1265.

42 Castillo-Ortiz, "Qeverisja gjyqësore dhe demokracia në Evropë" ("Judicial governance and democracy in Europe"), p. 4.

43 Profili i shtetit: Gjermania. Judiciary Hub (Democracy Reporting International GmbH), shiko në: <https://judiciaryhub.eu/country/germany/>.

44 Fabian Wittreck, "Vetëqeverisja gjyqësore gjermane - institucionet dhe kufizimet" ("German judicial self-government—institutions and constraints"), German Law Journal, 2018, <https://www.cambridge.org/core/journals/german-law-journal/article/german-judicial-selfgovernment-institutions-and-constraints/6C0EDAD79794CC792C5E7D34DFA14CD1>, p. 1946.

45 Anne Sanders and Luc von Danwitz, "Reforma e drejtësisë polake: Problematike sipas standardeve evropiane dhe një sfidë për Gjermaninë" ("The Polish judiciary reform: Problematic under European standards and a challenge for Germany") Verfassungsblog (blog), 28 mars, 2017, <https://verfassungsblog.de/the-polish-judiciary-reform-problematic-under-european-standards-and-a-challenge-for-germany/>, p. 3 - 4.

46 Raporti i Lirive për Sundimin e Ligjit 2024 ("Liberties Rule of Law Report 2024"), Civil Liberties Union for Europe, 2024), https://dq4n3btmxr8c9.cloudfront.net/files/oj7hht/Liberties_Rule_Of_Law_Report_2024_FULL.pdf, p. 248.

47 Profili i vendit: Republika Çeke. Judiciary Hub (Democracy Reporting International GmbH), shiko në: <https://judiciaryhub.eu/country/czechia/>.

48 "Raundi i katërt i vlerësimit: Parandalimi i korrupsionit në lidhje me deputetët, gjyqtarët dhe prokurorët" ("Fourth evaluation round: Corruption prevention in respect of members of parliament, judges and prosecutors, Second Compliance Report Czech Republic"), GRECO, 16 qershor, 2023), <https://rm.coe.int/fourth-evaluation-round-corruption-prevention-in-respect-of-members-of-1680ab9d42>, p. 6.

i zgjidhnin vetë gjyqtarët. Në një proces të tillë, kryetarët e gjykatave shfaqën nivele të ndryshme transparence dhe baza për favorizim dhe përzgjedhje bazuar në kritere të ndryshme dhe jo në meritë, duke rrezikuar përfundimisht pavarësinë e gjyqtarëve të emëruar.

Pas reformës së vitit 2022, komisionet përzgjedhëse tani zgjedhin kandidatët gjyqësorë dhe kryetarët e gjykatave përmes konkurseve të hapura duke filluar nga janari 2022. Ministria e Drejtësisë është përgjegjëse për paraqitjen e kandidatëve gjyqësorë dhe rekomandimin e kryetarëve të gjykatave të larta dhe rajonale te presidenti i republikës për emërim. Për më tepër, ministria emëron kryetarët e gjykatave të rretheve, merr vendime për ngritjet në detyrë dhe komandimet, si dhe përgatit buxhetin e gjyqësorit. Ministria gjithashtu fillon procedime disiplinore së bashku me kryetarët e gjykatave, dhe panelet disiplinore mund të vendosin sanksione disiplinore ndaj gjyqtarëve. Ka edhe trupa gjyqësorë që japin mendime për ngritjen në detyrë dhe komandimin e gjyqtarëve, ngarkesën e çështjeve të gjykatës dhe sistemin e caktimit të çështjeve. Edhe pse relativisht e re, reforma e lartpërmendur duket se kufizon ndikimin e kryetarëve të gjykatave në përzgjedhjen gjyqësore dhe zvogëlon rrezikun e presionit të brendshëm mbi gjyqtarët dhe rrezikun e zvogëlimit të pavarësisë gjyqësore. Megjithatë, sistemi i ri i emërimeve konsiderohet jopraktik nga presidentët e disa gjykatave në Republikën Çeke, sepse ata nuk lejohen të jenë anëtarë të komisioneve përzgjedhëse. Kështu, ata arritën në përfundimin se transparenca mbizotëronte mbi praktikitetin dhe se reformat e reja duhet të synojnë në atë drejtim.⁴⁹ Opinione të tilla bien ndesh me përpjekjet për të luftuar favorizimin dhe vendimmarrjen subjektive brenda gjyqësorit, çështje që vazhdojnë në aspekte të tjera të qeverisjes gjyqësore në Republikën Çeke. Konkretisht, në një rast që ka të bëjë me marrjen e masave disiplinore kundër një zyrtari përmbarimor, GJEDNJ-ja theksoi të meta të rëndësishme në sistemin e drejtësisë penale çeke, duke përfshirë mungesën e paanshmërisë dhe pavarësisë gjyqësore, si dhe proceset jotransparente të përzgjedhjes së gjyqtarëve.⁵⁰ Kjo nënvizon se si marrëdhëniet dhe mendimet subjektive mund të ndikojnë gjithashtu në procedurat disiplinore. Sugjeron se një reformë më gjithëpërfshirëse e gjyqësorit mund të jetë e nevojshme për të siguruar vendimmarrje objektive dhe të paanshme.

Pavarësia e perceptuar e modeleve të qeverisjes gjyqësore

Ndërsa nuk mund të identifikohet një model universalisht ideal i qeverisjes gjyqësore për çdo vend në botë, apo edhe vetëm në BE, modelet e zgjedhura në vendet e mësipërme mund të vlerësohen sipas kontributit të tyre në pavarësinë e perceptuar të gjyqësorit në ato vende. Sistemet efektive dhe të pavarura të drejtësisë janë thelbësore për zbatimin dhe ushtrimin e ligjit të BE-së dhe vlerave themelore të BE-së, si dhe për ndërtimin e besimit të qytetarëve në gjyqësor. Një mjet informues i BE-së që mat parametrat e efikasitetit, cilësisë dhe pavarësisë së sistemeve të drejtësisë në shtetet anëtare të BE-së është Tabela e rezultateve të drejtësisë së BE-së.⁵¹ Qëllimi i tij është të ndihmojë shtetet anëtare në përmirësimin e efektivitetit të sistemeve të tyre nacionale të drejtësisë duke siguruar të dhëna për parametrat e lartpërmendur.

Sipas të dhënave të fundit nga Tabela e rezultateve të drejtësisë së BE-së⁵² në lidhje me vendet e analizuar më parë, publiku i gjerë i percepton gjykatat dhe gjyqtarët në Gjermani si më të pavarurit, ndërsa Bullgaria shihet se ka gjyqësorin më pak të pavarur, ndërsa Polonia dhe Italia konkurrojnë ngushtë për renditje të ngjashme. Republika Çeke është diku në mes të këtij diapazoni, ndërsa Belgjika dhe Holanda perceptohen se kanë një gjyqësor pak më pak të pavarur se Gjermania. Këto të dhëna çojnë në përfundimin se qytetarët e vendeve që kanë një model shërbimi gjyqësor ose një model të Ministrisë së Drejtësisë të qeverisjes gjyqësore besojnë se sistemet e tyre gjyqësore janë më të pavarura në krahasim me ata që jetojnë në vendet me një model të këshillit gjyqësor.

49 "Raporti i Lirive për Sundimin e Ligjit 2023" ("Liberties Rule of Law Report 2023") Civil Liberties Union for Europe, 2023, https://dq4n3btxm8c9.cloudfront.net/files/-3lkvi/Liberties_Rule_of_Law_Report_2023_EU.pdf, p. 138.

50 ECtHR, "Rasti i Grosam kundër Republikës Çeke" ("Case of Grosam v. the Czech Republic") (A.no. 19750/13), qershor, 2023, <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22%3A%22001-225231%22%7D>.

51 "Tabela e rezultateve të drejtësisë në BE 2024 tregon se perceptimi i pavarësisë së gjyqësorit është përmirësuar." ("EU Justice Scoreboard 2024 Shows That Perception of Judicial Independence Has Improved.") Komisioni Evropian, 11 qershor, 2024, https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_24_3164.

52 Figura 51, "Tabela e rezultateve të drejtësisë së BE-së 2024" ("2024 EU Justice Scoreboard"), Komisioni Evropian, 11 qershor 2024, https://commission.europa.eu/document/download/84aa3726-82d7-4401-98c1-fee04a7d2dd6_en?filename=2024%20EU%20Justice%20Scoreboard.pdf, p. 45.

Modeli i qeverisjes gjyqësore në Maqedoninë e Veriut

Si vend kandidat për anëtarësim, Maqedonia e Veriut duhet të jetë në përputhje me vlerat e BE-së dhe të përmbushë kriteret e Kopenhagës. Kjo përfshin respektimin e sundimit të ligjit në vend, duke krijuar institucione publike që ofrojnë shërbime cilësore për qytetarët dhe funksionojnë në mënyrë të pavarur nga ndikimi politik, me qëllim të ofrimit të kushteve adekuate për ushtrimin e të drejtave të qytetarëve. Në këtë kuptim, një gjyqësor funksional është thelbësor në ruajtjen e këtyre të drejtave dhe modeli i zgjedhur i qeverisjes gjyqësore ndikon ndjeshëm në efektivitetin e tij. Në Maqedoninë e Veriut, një këshill gjyqësor u prezantua përmes një sërë ndryshimesh kushtetuese për gjyqësorin të miratuara në vitin 2005,⁵³ me institucionin e themeluar zyrtarisht në vitin 2006. Aktualisht, ai përbëhet nga pesëmbëdhjetë anëtarë, nga të cilët tetë anëtarë janë gjyqtarë të zgjedhur nga radhët e tyre, tre anëtarë zgjidhen nga Kuvendi dhe dy anëtarë propozohen nga presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe zgjidhen nga Kuvendi. Nga ana tjetër, kryetari i Gjykatës së Lartë dhe ministri i Drejtësisë janë anëtarë ex officio të Këshillit Gjyqësor.⁵⁴ Ai mbart të gjitha kompetencat që karakterizojnë këtë model: monitorimi dhe vlerësimi i punës së gjyqtarëve, emërimi, ngritja në detyrë dhe shkarkimi i gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave, përcaktimi i përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarëve, vendosja për ngarkesën e çështjeve dhe veprimi mbi kërkesat dhe ankesat e qytetarëve dhe personave juridikë në lidhje me punën e gjyqtarëve, kryetarëve të gjykatave dhe gjykatave.

Qëllimi i futjes së këtij modeli të qeverisjes gjyqësore në vend ishte krijimi i një institucioni që është i izoluar nga ndikimi i degëve ekzekutive dhe legjislativ dhe që do të marrë vendime në lidhje me karrierën gjyqësore dhe funksionimin e gjykatave në mënyrë të pavarur. Maqedonia e Veriut ishte një nga vendet e para kandidate që prezantoi këtë lloj reforme në gjyqësor dhe vlerësohet se ka arritur një nivel të lartë të përafrimit të kornizës së saj ligjore me standardet e BE-së sa i përket pavarësisë gjyqësore.⁵⁵ Megjithatë, është e qartë se funksionimi i sistemit gjyqësor nuk është përmirësuar ndjeshëm. Ka pasur pretendime të kaluara për emërim, promovime dhe shkarkime të gjyqtarëve të motivuar politikisht, së bashku me ndikimin e qeverisë dhe partive politike mbi vendimet gjyqësore të profilit të lartë.⁵⁶ Kohët e fundit, ish-kryetarja e Këshillit Gjyqësor përmendi presionin nga elita e biznesit gjyqësor si arsye për dorëheqjen e saj.⁵⁷ Më pas, nga KE janë shënuar një sërë ngjarjesh shqetësuese në Këshillin Gjyqësor me fillim nga dhjetori 2022, duke përfshirë shkarkimin e diskutueshëm të Kryetarit aktual të Këshillit dhe mosmarrëveshjen gjyqësore administrative në lidhje me të.⁵⁸ Kjo gjë rezultoi në rekomandimin që vendi të rishikojë kornizën legjislativ dhe funksionimin e përgjithshëm të Këshillit në mënyrë që ta mbrojë atë nga ndikimi i panevojshëm politik dhe të rrisë transparencën dhe pavarësinë e tij. Pas këtij vlerësimi të bërë nga KE, një mision shqyrtues nga BE analizoi punën e Këshillit Gjyqësor dhe ngjarjet e lartpërmendura,⁵⁹ pas së cilës përgatiti një raport mbi funksionimin e Këshillit me dyzet rekomandime afatshkurtra dhe afatmesme për përmirësimin e punës së tij. Shtatëmbëdhjetë prej këtyre rekomandimeve i referohen përmirësimit të praktikës dhe funksionimit të vetë Këshillit Gjyqësor. Ato mund të zbatohen pa ndonjë ndryshim legjislativ. Nga ana tjetër, të tjerat përfshijnë ndryshime kushtetuese ose legjislativ dhe i referohen përbërjes së Këshillit, përgjegjësisë së anëtarëve të Këshillit dhe kohëzgjatjes së mandatit të tyre, procedurës dhe vendimit për sanksionimin e gjyqtarëve, si dhe aspekteve të tjera të qeverisjes gjyqësore.⁶⁰ Anëtarët aktualë të Këshillit Gjyqësor kanë refuzuar

53 Amendamenti XX-XXX i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr. 107/2005.

54 Ligji për Këshillin Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut Nr. 102/2019.

55 Denis Preshova, Ivan Damjanovski, and Zoran Nechev, "Efektiviteti i 'modelit evropian' të pavarësisë së gjyqësorit në Ballkanin Perëndimor: Këshillat Gjyqësorë si zgjidhje apo shkak i ri shqetësimi për reformat në drejtësi" (The effectiveness of the 'European model' of judicial independence in the Western Balkans: Judicial councils as a solution or a new cause of concern for judicial reforms" (Centre for the Law of EU External Relations, T.M.C. Asser Instituut inter-university research centre, 2017), https://www.asser.nl/media/3475/cleer17-1_web.pdf, p. 25.

56 Ibid.

57 "Cërvenkovski me dorëheqje dhe akuzë për ndikim të elitës gjyqësore-afariste në Këshillin Gjyqësor," Telma TV, 29 nëntor, 2022, <https://telma.com.mk/2022/11/29/crvenkovski-so-ostavka-i-obvinuvanja-za-vlijanie-na-sudsko-biznis-elitata-vrz-sudskiot-sovet/>.

58 "Raporti i Maqedonisë së Veriut 2023", Komisioni Evropian, 2023, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_693%20North%20Macedonia%20report.pdf, p. 18.

59 Ka përfunduar misioni shqyrtues i BE-së për Këshillin Gjyqësor, priten masa" 360 shkallë, 23 shtator, 2023, <https://360stepeni.mk/otsenskata-misija-na-eu-za-sudskiot-sovet-zavrshi-se-ochekuvaat-merki/>.

60 "Këshilli gjyqësor po përgatit një strategji të re komunikimi", Kanal 5, 26 prill, 2024, <https://kanal5.com.mk/sudskiot-sovet-podgotvuva-nova-komunikaciska-strategija/a637440>.

të japin dorëheqjen pavarësisht kritikave të BE-së dhe organizatave të shoqërisë civile në vend,⁶¹ por kanë shprehur qëllimin e tyre për të punuar në zbatimin e rekomandimeve të marra nga misioni i shqyrtues,⁶² nëpërmjet prezantimit të amandamenteve të Rregullores procedurale.⁶³

Konkluzione

Kjo analizë shqyrton tetë shtete të ndryshme anëtare të BE-së që kanë miratuar një nga tri modelet më të zakonshme të qeverisjes gjyqësore. Nga shqyrtimi i përvojave të tyre, bëhet e qartë se nuk ka model të përsosur të qeverisjes gjyqësore pa mangësi. Secili sistem ka hasur sfida që kërcënojnë sundimin e ligjit dhe demokracinë. Përfshirja e Maqedonisë së Veriut në këtë vlerësim, me çështjet e saj komplekse që rrethojnë këshillin gjyqësor, përforcon të kuptuarit se asnjë model nuk është i përsosur. Secili vend duhet të shqyrtojë me kujdes qasjen e tij ndaj qeverisjes gjyqësore dhe t'u përshtatet rrethanave aktuale gjyqësore, duke synuar ruajtjen e pavarësisë gjyqësore dhe ruajtjen e parimeve të sundimit të ligjit dhe demokracisë në shoqëritë e tyre.

61 “Kërkohet dorëheqje kolektive dhe zgjedhje publike e anëtarëve të rinj të Këshillit Gjyqësor nga organizatat e shoqërisë civile.” Radio Evropa e Lirë, 9 qershor, 2023, <https://bit.ly/4dclpi9>.

62 “Këshilli Gjyqësor lajmëron zbatimin e rekomandimeve të misionit shqyrtues të BE-së” Radio Evropa e Lirë, 26 prill, 2024, <https://www.slobodnaevropa.mk/a/32922184.html>.

63 Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores procedurale për punën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut Nr. 117/2024).

